

Përfitueshmëria Dhe Përcaktuesit E Saj: Shqipëria

Dr. Arjeta Hallunovi

Departamenti i Financë-Kontabilitetit

Fakulteti i Biznesit

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Shqipëri

arjeta26@yahoo.com

Abstrakt-Sistemi financiar ndërkombëtar po ndryshon me shpejtësi, ekonomitë dhe sistemet financiare janë duke kaluar nëpër vite traumatike. Globalizimi dhe teknologjia janë në shpejtësi të vazhdueshme dhe arenat financiare po bëhen më të hapura ndaj produkteve dhe shërbimeve të reja[1]. Një valë ndërkombëtare e bashkimeve dhe blerjeve ka përfshirë industrinë bankare, sa që kufinj të ndërmjet sektorëve financiarë dhe produkteve janë të paqarta dramatikisht (Amdemikael, 2012). Prandaj, identifikimi i faktorëve që ndikojnë përfitimin e bankave tregtare është i rëndësishëm për palët e interesuara të tilla si, bankat qëndrore, qeveritë, shoqatat e bankierëve dhe autoritetet e tjera financiare, si edhe për drejtuesit e bankave (Rajan dhe Zingales 1998; Levine 1998; Pasiouras dhe Kosmidou, 2007; Ayayi, 2012; Birnahu, 2012). Ky studim shqyrton përcaktuesit e përfitueshmërisë të bankave tregtare në Shqipëri.

Fjalët kyçe: Faktorët Specifikë Bankarë, Faktorët Specifikë të Industrisë, Faktorët Makroekonomikë, Përfitueshmëria, RoA, Shqipëria.

I. Hyrje

Në dekadat e fundit, shumica e vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore kanë adoptuar reformat strukturore në funksion të rritjes së madhësisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemeve financiare. Hapja me pjesën e jashtme dhe reformat e brendshme strukturore të sektorit financiar kanë përkrahur zhvillimin e një sistemi financiar konkurrues dhe efikas. Në industrinë financiare, bankat përfaqësojnë institucionet financiare të një rëndësie të lartë, ku niveli i përfitimit gjithmonë ka një ndikim të madh në ekonominë globale.

Studimi i përfitueshmërisë është i rëndësishëm jo vetëm për shkak të informacionit që jep në lidhje me shëndetin e ekonomisë çdo vit, por edhe për shkak se fitimet janë një përcaktues kryesor i rritjes dhe punësimit në periudhën afatmesme[2]. Ndryshimet në përfitueshmëri janë një kontribues i rëndësishëm në progresin ekonomik nëpërmjet ndikimit që fitimet kanë mbi vendimet për investime dhe kursime të kompanive[3]. Kjo për shkak se një rritje në fitime përmirëson pozitën e rrjedhës së parave të gatshme të kompanive dhe ofron fleksibilitet më të madh në burimin e financave për investime të korporatave (p.sh. nëpërmjet fitimit të pashpërndarë). Qasja më e lehtë në financa lehtëson investimet në një nivel më të madh duke nxitur produktivitetin, aftësinë prodhuese, konkurrencën dhe punësimin [4] [5]. Është një fakt i njohur se bankat janë faktori kryesor kontribues në zhvillimin ekonomik të çdo vendi pasi ato qëndrojnë në qendër të ekonomisë për shkak të rolit të tyre si ndërmjetës financiarë [6]. Sektori bankar mund të konsiderohet si një derivat për përparimin e ardhshëm dhe zhvillimin e ekonomive vendore dhe ndërkombëtare [7].

Një numër i konsiderueshëm studimesh janë kryer në fushën e përfitimit të bankave tregtare dhe përcaktuesve të saj, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj fushe në nivel ndërkombëtar. Ata verifikuan se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis përfitimit në industrinë e bankave tregtare dhe përcaktuesve të saj të brendshëm dhe të jashtëm [8] [9] [10]. Megjithatë shumë kërkues kanë kryer studime në këtë fushë, përcaktuesit e përfitueshmërisë kanë qënë në qendër të debateve për shumë vite dhe janë akoma një çështje e pazgjidhur në literaturën financiare. Ajo që e bën debatin për përcaktuesit e përfitueshmërisë është fakti se këto përcaktues janë dinamike nga koha në kohë dhe ndryshojnë me natyrën e operimit të firmës nga një vend në

tjetrin [11] [12]. Kështu që, konkludohet se nuk ka gjetje të pranuar universalisht për përcaktuesit e përfitueshmërisë të sektorit bankar. Për shkak se vendet ndryshojnë me njëri-tjetrin nga sistemet e tyre ekonomike, sistemet financiare, sistemet politike dhe mjediset operative.

II. Metodologjia

Në studim është përdorur një panel të dhënash me 16 banka tregtare, të cilat janë analizuar për periudhën kohore 2009-2014, duke konsideruar 96 vëzhgime. Për matjen e përfitueshmërisë është përdorur kthimi nga aktivet (RoA), ndërsa si variabla të pavarura janë përdorur madhësia e bankës, menaxhimi i aktiveve, risku kreditor, likuiditeti i aktiveve, mjaftueshmëria e kapitalit, efica operacionale, kosto e financimit, përqëndrimi, aktiviteti ekonomik, inflacioni dhe norma e kursit të këmbimit. Të dhënat sasiore janë marrë kryesisht nga pasqyrat financiare të bankave tregtare, nga INSTAT, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore dhe Bankscope, në mënyrë që të bëhen analizat empirike të nevojshme për të identifikuar dhe matur përcaktuesit e përfitimit të bankave tregtare. Për të matur efektin e përcaktuesve të përfitimit bankarë nga ana sasiore është përdorur analiza e regresionit të shumëfishtë. Për realizimin e analizave empirike për modelin është përdorur softwari SPSS 22 dhe Eviews 7.

Në funksion të studimit janë ngritur hipotezat e mëposhtme:

H₀: Faktorët specifik bankarë, të industrisë dhe makroekonomik nuk ndikojnë tek përfitueshmëria (RoA) e bankave tregtare.

H₁: Të paktën një nga faktorët specifik bankarë, të industrisë dhe makroekonomik ndikon tek përfitueshmëria (RoA) e bankave tregtare.

III. Analiza e të dhënave dhe gjetjet

Para se të vazhdohej me analizën ekonometrike të të dhënave, hapi i parë që u ndërmorr ishte testimi i vlefshmërisë së modelit, duke verifikuar ndërmjet testeve përkatëse nëqoftëse ishin përmbushur supozimet e modelit klasik të regresionit linear (CLR). Rezultatet e testeve përmbledhen në tabelën 1 si mëposhtë:

Tabela 1. Testet për vlefshmërinë e modelit.

Testi	Lloji i testit	Statistika	Hipoteza
Normalitetit	Jarque - Bera	JB=2.36 Prob 0.306790	Shpërndarja e termave të gabimit është normale.
Heteroskedasticitetit	White Test	Obs*R-squared=0.2713	Mbetjet kanë variancë të njëjtë.
Autokorrelacionit	Durbin Watson	d>dU 2.039>1.930	Gabimet nuk kanë korrelacion serial.
Formës funksionale	Ramsey RESET	Prob 0.0861	Forma funksionale është lineare.

Burimi: Llogaritje të autorit.

Pas testimit të hipotezave për verifikimin e supozimeve të modelit klasik të regresionit linear për vlefshmërinë e modeleve, u konstatua se hipotezat bazë të ngritura nuk u hodhën poshtë. Prandaj, me bindje mund të thuhet se modeli linear është më i përshtatshmi nga ana funksionale sipas testeve të gjeneruara dhe modeli i përdorur për të analizuar lidhjen ndërmjet variablave të përdorura është i duhuri. Gjithashtu, në matricën e korrelacionit, koeficientët ishin më të ulët se 0.7, kështu që, këto vlera të ulta vertetuan përsëri se studimi nuk ka probleme të multikolinearitetit.

Rezultatet e vlerësimit të analizës së regresionit për modelin (ku si variabël i varur u përdor kthimi nga aktivet), me të dhënat panel të përdorura janë paraqitur në tabelën 2. Nga ku vërejmë se statistikën R^2 dhe R^2 e korrigjuar të modelit janë 56.6% dhe 50.9% respektivisht. Rezultati tregon se ndryshimet në variablat e pavarura shpjegojnë 50.9% të ndryshimeve në variablin e varur (RoA). Ndërsa pjesa e mbetur prej 49.1% e ndryshimeve shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë përfshirë në model. Kështu këto variabla bashkërisht, janë variabla të mira shpjeguese të përfitimit të bankave tregtare në Shqipëri.

Raporti i kapitalit dhe përfitueshmëria e bankave e shprehur me RoA kanë një lidhje pozitive midis tyre, rezultate të pritshme dhe të ngjashme me studime të autorëve të tjerë [13] [14] [15] [16]. Pritej që sa më i lartë të ishte raporti i kapitalit ndaj totalit të aktiveve, aq më e mirë kapitalizuar do të ishte banka dhe si rrjedhim banka do të përballet me kosto më të ulët ndaj falimentimit (duke qënë se mjaftueshmëria e kapitalit është një raport që tregon për aftësinë e bankës për të absorbuar

humbjet dhe trajtuar ekspozimin e rrezikut me aksionerët) meqënëse ka më pak rrezik, dhe aq më e ulët do të ishte nevoja për financime të huaja dhe për këtë arsye aq më i lartë është përfitimi i bankës. Ku sigurisht, që një nivel më i lartë i raportit të kapitalit (ku, ky raport nxjerr në pah mjaftueshmërinë e kapitalit dhe tregon për qëndrueshmërinë e institucionit financiar), nxit për një nivel më të lartë të përfitimit, dhe në këtë mënyrë një bankë mund t'i përmbahet lehtësisht standarteve të kapitalit rregullator, duke ofruar si kredi, kapitalin e tepërt.

Risku kreditor (0.0275) në studim është i rëndësishëm në nivelin e rëndësisë 5% dhe ekziston një lidhje negative midis tij dhe përfitueshmërisë (RoA) në banka. Risku kreditor, deri tani është risku më i rëndësishëm me të cilin përballen bankat tregtare dhe sukcesi i biznesit të tyre varet nga matja e saktë dhe menaxhimi eficient i tij, në një masë më të madhe se çdo lloj risku tjetër [17]. Rritja e riskut të kredisë rrit koston marxhinale të borxhit dhe kapitalit, të cilat nga ana tjetër e rritin koston e fondeve për bankën [18]. Pritej që risku kreditor të kishte një ndikim negativ mbi përfitueshmërinë (RoA) duke interpretuar konceptin se sa më shumë kredi të këqija të ketë banka aq më shumë do të reduktohet përfitueshmëria e saj. Ky është një përfundim i ngjashëm edhe me studime të autorëve të tjerë [19] [20] [21]. Rezultatet nga analiza empirike treguan se midis madhësisë së bankës dhe përfitueshmërisë (RoA) ka një lidhje statistikore (0.0715) të rëndësishme në nivelin 10%, dhe ato janë lidhur pozitivisht midis tyre. Një marrëdhënie pozitive tregon se banka gëzon ekonominë e shkallës, e cila zvogëlon koston e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit. Ky përfundim reflektohet edhe sipas të dhënave në literaturë, nga studime të autorëve të tjerë [22] [23].

Aktiviteti ekonomik (0.0002) si një faktor makroekonomik në studim është statistiki i rëndësishëm me nivelin e rëndësisë 1% dhe është i lidhur pozitivisht me përfitueshmërinë (RoA) sikurse evidentohet edhe nga provat empirike të autorëve të tjerë [24][25]. Mbështetur në analizën e regresionit për modelin, likuiditeti i aktiveve (0.1816) ishte i parëndësishëm si dhe lidhej negativisht me përfitueshmërinë (RoA) të bankave tregtare.

Mbajtja e aktiveve në një formë shumë likuide ka tendencë për të ulur të ardhurat, pasi aktivet likuide janë të lidhura me norma kthimit më të ulëta. Kështu që ulja e nivelit të aktiveve likuide do të sjell në mënyrë të pashmangshme edhe rritjen e fitimit. Edhe sipas hulumtimit në literaturë [26] pritej një marrëdhënie e anasjelltë midis likuiditetit të aktiveve dhe përfitueshmërisë bankare.

Tabela 2. Analiza e regresionit për modelin.

Dependent variable: ROA
 Method: Panel Least Squares

Variable	Coefficient	Prob.	Prob.
C	-0.026813	0.4505	0.2933
MADH	0.001949	0.0170	0.0715
MAK	0.058057	0.0653	0.0091
RKR	-0.013100	0.0166	0.0275
LIK	-0.009329	0.9100	0.1806
EOP	-0.005847	0.5355	0.5963
KAP	1.064200	0.0690	0.0065
KFN	-0.216281	0.6420	0.2610
PRQ	-0.055812	0.4968	0.2103
AEK	0.081546	0.0098	0.0002
INF	0.011908	0.3154	0.1390
NKK	0.001398	0.3638	0.2598
R-squared	0.566116		0.023710
Adjusted R-squared	0.509298		0.009657
S.E. of regression	0.006765		-7.037617
Sum squared resid	0.003844		-6.717073
Log likelihood	349.8056		-6.908048
F-statistic	9.963662		1.975234
Prob(F-statistic)	0.000000		

Burimi: Llogaritje të autorit.

Të dhënat nga analiza empirike për raportin kosto të ardhura (0.5986) treguan që është një variabël i parëndësishëm, por që është i lidhur negativisht me përfitueshmërinë. Ky faktor është përdorur si një tregues i aftësisë së drejtimit për të kontrolluar kostot dhe siç pritej ai ka një lidhje negative me fitimin, pasi menaxhimi i përmirësuar i këtyre shpenzimeve do të rrit eficientësinë dhe për këtë arsye do të rrit edhe fitimet në banka. Edhe sipas studimeve të tjera [27] [28], pritej një marrëdhënie negative midis variablave.

Kosto e financimit (0.262) rezultoi statistiki i rëndësishëm por negative në marrëdhënien e saj me përfitimin (RoA), duke konkluduar se një kosto më e ulët pritet të gjenerojë një kthim më të mirë, kur fondet janë vendosur në formë afatshkurtër dhe afatgjatë si kredi për

huamarrësit. Rezultate të pritshme edhe nga hulumtimet e autorëve [29] [30].

Përqëndrimi (0.2103) si i vetmi variabël specifik i industrisë nuk është statistikisht i rëndësishëm për fitimin (RoA) në bankat tregtare dhe ka një lidhje negative me të [31]. Pavarësisht se nga literatura nuk ka një përfundim të qartë për lidhjen e përqëndrimit me përfitueshmërinë [32], pritej një marrëdhënie pozitive midis variablilit shpjegues dhe RoA. Sa më shumë e përqëndruar të jetë industria, aq më e madhe do të jetë fuqia monopoliste e firmave. Kjo, nga ana tjetër, përmirëson marzhet e fitimit të bankave. Mbi bazën e rezultateve të gjeneruara, modeli ekonometrik jepet si mëposhtë:

$$\text{ROA}_{it} = -0.026813 + 0.001949 (\text{MADH})_{it} + 0.058057 (\text{MAK})_{it} - 0.013100 (\text{RKR})_{it} - 0.009329 (\text{LIK})_{it} - 0.005847 (\text{EOP})_{it} + 1.064200 (\text{KAP})_{it} - 0.216281 (\text{KFN})_{it} - 0.055812 (\text{PRQ})_{it} + 0.081546 (\text{AEK})_{it} + 0.011908 (\text{INF})_{it} + 0.001398 (\text{NKK})_{it} + \varepsilon_{it}$$

IV. Rekomandime

*Variablat specifike bankare paraqiten fuqimisht më të rëndësishme sesa faktorët e jashtëm për të shpjeguar ndryshueshmërinë në modelin e përfitueshmërisë për bankat tregtare në Shqipëri. Megjithatë në mesin e faktorëve të jashtëm të përfshirë në këtë studim, aktiviteti ekonomik paraqitet si një matës statistikisht i rëndësishëm i përfitimit të bankave tregtare shqiptare. Prandaj, rekomandohet për të gjitha bankat tregtare që të marrin parasysh edhe mjedisin makroekonomik gjatë hartimit të strategjive për të përmirësuar performancën e tyre apo fitimet në veçanti.

*Madhësia e bankës, menaxhimi i aktiveve, risku kreditor, mjaftueshmëria e kapitalit dhe aktiviteti ekonomik janë tregues të rëndësishëm të përfitimit të bankave tregtare në Shqipëri. Rekomandohet, se duke u përqëndruar në përmirësimin e këtyre treguesve mund të rritet mundësia për përmirësimin e përfitueshmërisë së bankave tregtare, si dhe performancës së tyre.

*Ekonomia e shkallës rrjedh nga madhësia e bankës që luan një rol vendimtar në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Përfitimi nga madhësia e bankës reflektohet në aftësinë për të arritur në tregje më të gjëra. Prandaj, bankat tregtare duhet të inkurajohen për të parë përtej tregut vendor dhe të zgjerojnë operacionet e tyre në tregje të tjera gjeografike dhe sektorë të

tjerë të ekonomisë. Rekomandohet që bankat tregtare mund të zgjerojnë veprimtarinë operacionale të tyre në Kosovë. Gjithashtu, rekomandohet që sektori i bujqësisë dhe turizmit mund të jetë ende një treg potencial për bankat tregtare.

*Rekomandohet menaxherëve të bankave tregtare që të sigurohen që të kenë një menaxhim eficient të likuiditetit në mënyrë që bankat tregtare të jenë të afta për të paguar detyrimet e tyre në periudhat afatshkurta dhe afatgjata. Kjo mbështetur në një rezultat interesant i gjeneruar nga intervistat me drejtuesit e financës të bankave tregtare, të cilët pohuan se realisht bankat tregtare karakterizohen nga nivele likuiditeti të ulta, pavarësisht se në studim evidentohet një raport likuiditeti i lartë, bazuar në statistikat përshkruese. Sipas, tyre arsyeja për ekzistencën e likuiditetit të lartë si rezultat i statistikave përshkruese ka të bëjë me klasifikimin e disa llogarive si rezervë apo i bonove të thesarit, si aktive likuide mbi të cilat bankat tregtare në fakt nuk kanë të drejtë për kreditim apo për qëllime të tjera.

*Përqëndrimi si variabël specifik i industrisë bankare në studim ndikon negativisht përfitueshmërinë duke nënkuptuar që bankat tregtare nuk janë eficiente dhe inovative. Kështu që, rekomandohet se sektori bankar duhet të liberalizohet pak më shumë duke lejuar investitorët të bëhen pjesë e tij. Kjo jo vetëm që do të nxiste konkurrencën, por do të ishte një vlerë shtesë për shërbimet e kryera ndaj konsumatorëve. Përqëndrimi i lartë mund të pengojë arritjen e objektivave të politikës monetare.

*Siç mbështetet edhe nga literatura, një ekonomi e shëndetshme është një parakusht për një sistem bankar të shëndetshëm. Prandaj, marrëdhënia pozitive midis produktit të brendshëm bruto dhe përfitueshmërisë bankare është në përputhje me teorinë. Kështu, politikat e qeverisë për punësimin dhe investimet duhet të intensifikohen për të rritur përfitueshmërinë e bankave tregtare. Në një ekonomi, ku qeveria stimulon krijimin e vendeve të punës dhe krijon klimën e duhur të investimeve për investitorët vendas dhe të huaj, bankat tregtare ka të ngjarë të forcohen edhe më shumë.

V. Referenca

- [1] Gul, S., Irshad, F. dhe Zaman, K. (2011). Factors affecting bank profitability in Pakistan. *The Romanian Economic Journal*, XIV (39), 61-87.
- [2] Davydenko A. (2010), Determinants of Bank Profitability in Ukraine, *Undergraduate Economic Review*, Volume 7, Issue 1.
- [3] Davcev, L., dhe Hourvoulides, N. (2009). Profitability Parameters in the Banking System of Macedonia. *Proceedings of International Conference on Applied Economics*.
- [4] Okoth ,V dhe Gemechu, B (2013). Determinants of Financial Performance of Commercial Banks in Kenya, *International Journal of Economics and Financial, Issues Vol. 3, no. 1*
- [5] Uzhegova, O. (2010). The Relative Importance of Environmental Factors for Bank Profitability in Developed and Emerging Economies. Working Paper.
- [6] Olson, D. dhe Zoubi, A.T. (2011). Efficiency and bank profitability in MENA countries, *Emerging Markets Review*, Vol. 23, 94–110.
- [7] Zainol, Z. dhe Kassim, S.H. (2010). An Analysis of Islamic Banks Exposure to Rate of Return Risk. *Journal of Economic Cooperation*, 31(1), 59-84.
- [8] Weersainghe, V dhe Ravinda, T (2013). Determinants of profitability of Commercial Banks in Srilanka, *International Journal of Arts and commerce*, vol.2 No.10.
- [9] Wirnkar, A.D dhe Tanko, M. (2008). CAMEL(S) and Banks Performance Evaluation: The Way Forward.
- [10] Yadollahzadeh, N, Ahmadi, M dhe Soltan, M, (2013), ‘The Effective Factors on profitability of Commercial Banks in Iran’, *World of Sciences Journal*.
- [11] Said, R.M. dhe Tumin, M.H. (2011). Performance and Financial Ratios of Commercial Banks in Malaysia and China, *International Review of Business Research Papers*, Vol.7(2), 157-169.
- [12] Kosmidou, K. (2008). The determinants of Bank’s profit in Greece during the period of EU Financial Integration. *Manegerial Finance*, Issue, 34, 146 – 159.
- [13] Kanas, A., Vasiliou, D. dhe Eriotis, N. 2012. Revisiting bank profitability: A semi-parametric approach. *Journal of International Financial markets, Institutions and Money* (22)4, 990-1005.
- [14] Poposka, K. dhe Trpkoski, M. (2013). Secondary Model for Bank Profitability Management – Test on the Case of Macedonian Banking Sector. *Research Journal of Finance and Accounting*, Vol.4, No.6.
- [15] Obamuyi, T. M. (2013). Determinants of banks’ profitability in a developing economy: Evidence from Nigeria. *Organizations and Markets in Emerging Economies*, 4, 2(8), 97-111.
- [16] Naaborg, I. dhe Lensink R. (2008). Banking in transition economies: does foreign ownership enhance profitability?, *The European Journal of Finance*, Vol. 14, No 7, 545-562.
- [17] Mathuva, D.M. (2009). Capital adquacy, Cost income ratio and the performance of commercial Banks; The Kenyan scenario. *International Journal of Applied Economics and Finance*, Vol. 3, No. 2, 35 – 47.
- [18] Frederic, N. K. (2014). Factors affecting performance of commercial banks in Uganda: A case for domestic commercial banks. *International Business Research Conference*, South Africa.
- [19] Fadzlan, S. (2010). Financial depression and the profitability of the banking sector of the republic of Korea: Panel evidence on bank-specific and macroeconomic determinants. *Asia-Pacific Development Journal* 17 (2). 65-92.
- [20] Hassan, K. dhe Bashir M. (2003). Determinants of Islamic Banking Profitability, *International Seminar on Islamic Wealth Creation*, University of Durham, U.K.
- Brissimis, S. N., [21] Delis, M. D. dhe Papanikolaou, N. I. (2008). Exploring the nexus between banking sector reform and performance: Evidence from newly acceded EU countries. *Journal of Banking and Finance* 32(12): 2674-2683.
- [22] Berger, A. N. dhe Loretta J. M. (1997). Inside the Black Box: What Explains Differences in the Efficiencies of Financial Institutions. *Journal of Banking and Finance*, 895-947.
- [23] Agusman, A., Monroe, G.S., Gasbarro, D., dhe Zumwalt, J.K. (2008). Accounting and capital market measures of risk: evidence from Asian banks during 1998-2003. *Journal of Banking and Finance*, 32(4).

- [24] Allen, A. J., Shaik, S., Myles, A. E. dhe Yeboah, O. A. (2011). Determinants of Profitability Performance: An Analysis of Class I Railroads in the United States.
- [25] Agoraki, M., Delis, M.D., dhe Pasiouras, F. (2011). Regulations, competition and bank risk-taking in transition countries. *Journal of Financial Stability*, 7(1).
- [26] Hannan, T.H. dhe Prager, R.A. (2009). The profitability of small single-market banks in an era of multi-market banking, *Journal of Banking & Finance*, Vol. 33(2), 263–271.
- [27] Hirtle, B. J. dhe Stiroh, K. J. (2007). The return to retail and the performance of US Banks. *Journal of Banking and Finance* 31(4): 1101-1133.
- [28] Lamarana, M (2012). Financial Performance of the Malaysian Banking Industry Domestic vs Foreign Banks, Eastern Mediterranean University.
- [29] Masood, O dhe Ashraf, M (2012). Bank Specific and Macroeconomic Profitability Determinants of Islamic Banks, *Qualitative Research in Financial Markets*, Vol.4, no.2/3.
- [30] Ongore, V. O. dhe Kusa, G. B. (2013). Determinants of financial performance of commercial banks in Kenya. *International Journal of Economics and Financial Issues*, 3(1), 237-252.
- [31] Berger, A.N. dhe Humphrey, D.B. (1997). Efficiency of Financial Institutions: International survey and directions for future research, *European Journal of Operational Research*, 98, 175-212.
- [32] Beck, T. Cull, R. dhe Afeikhena, J. 2005. Bank privatization and performance: empirical evidence from Nigeria. *Journal of Banking and Finance* 29 (8-9). 2355–2379.